



A K E P

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RAPORTI VJETOR 2010

www.akep.al

info@akep.al

Përmbajtja

MESAZH	4
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE	6
1 PANORAMË E PËRGJITHSHME	10
1.1 Telefonia Celulare	13
1.1.1 Pjesët e tregut të operatorëve celularë	13
1.1.2 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare	16
1.2 Telefonia Fikse	17
1.2.1 Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut	17
1.2.2 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom	17
1.3 Interneti	19
1.3.1 Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet dhe struktura e tyre	19
2 VEPRIMTARIA E RREGULLIMIT EKONOMIK TË TREGUT	20
2.1 Analizat e Tregjeve	21
2.1.1 Procesi i analizave të tregjeve gjatë vitit 2010	21
2.2 Rregullimi i Interkoneksioni	22
2.2.1 Tarifat	22
2.2.2 Rregullore dhe RIO-t	23
2.3 Përcaktimi i kostos së ofrimit të shërbimeve nga operatorët me FNT	23
3 VEPRIMTARIA E RREGULLIMIT TEKNIK	24
3.1 Administrimi i spektrit të frekuencave	24
3.2 Miratimi i standardeve dhe treguesve të cilësisë së shërbimit	25
3.3 Administrimi dhe liberalizimi i vazhdueshëm i domain-eve nën .al	25
4 VEPRIMTARIA JURIDIKE NË RREGULLIM	26
4.1 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të telekomunikacionit	26
4.2 Pjesëmarrja në procese gjyqësore	26
5 VEPRIMTARIA INSPEKTUESE DHE MONITORUESE	26
5.1 Veprimtaria inspektuese	26
5.2 Veprimtaria monitoruese	27
6 RREGULLIMI I TREGUT POSTAR	28
7 STRUKTURA DHE BURIMET NJERËZORE	28
8 REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË VJETORË TË AKEP	28

MESAZH

Viti 2010 ka qenë një vit sfidash për AKEP, i cili u mobilizua në përmbushje të detyrimeve të konsideruara të prioritetit të lartë.

Si ngjarje më kryesore me efekte sinjifikative në sektor do të përmendja:

- Dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të standardit 3G.

Pas një procesi transparent studimi, këshillimi publik me grupet e interesit, bashkëpunimi me Ministrin për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e Komunikimit, dhe në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, sipërmarrësi “Vodafone Albania” u shpall fitues për ofrimin e shërbimeve të lëvizshme tokësore me brez të gjerë sipas standardit IMT-2000/UMTS. “Vodafone Albania” më datë 10 Janar 2011, prezantoi për herë të parë në treg këto shërbime.

AKEP përmbushi kështu një nga objektivat më të rëndësishëm që kishte për vitin 2010 duke i hapur rrugën tregut të shërbimeve “wireless” me bandë të gjerë. Kjo krijon një mbështetje të fuqishme në rrugën e përmbushjes së objektivave të Qeverisë “Internet për të gjithë” dhe “Shqipëria në moshën e Internetit”.

- Firmosja e kontratës me firmën fituese për “Ngritjen e një Baze të Dhënash Reference për Ofrimin e Portabilitetit të Numrit” më datë 22 Dhjetor 2010, e cila mundësoi ofrimin e shërbimit të bartjes së numrit në muajin Maj 2011. Implementimi i portabilitetit të numrit ishte një detyrim ligjor i përealizuar, gjithashtu kërkesë e BE-së, që barjten e numrit e konsideron si një të drejtë të përdoruesit fundor për maksimizim përfitimesh me kosto minimale.
- Dalja komerciale në treg më 27 Nëntor 2010, e operatorit të katërt të telefonisë së lëvizëshme “Plus Communication”, premise për vendosjen e një konkurrence eficiente në tregun e telefonisë të lëvizëshme.

Gjatë vitit 2010, kemi punuar për të siguruar kuadrin e nevojshëm rregullator të sektorit që inkurajon investimeve dhe jep garanci për konkurrencë eficiente dhe përfitime për konsumatorin. Kuadri ligjor dhe rregullator i hartuar si dhe klima e përgjithshme e favorshme për investime solli rritjen e interesit të subjekteve për të hyrë në tregun e telekomunikacioneve. Numri i sipërmarrësve të cilët njoftuan AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri në fund të vitit 2010 ishte 196 në krahasim me 152 në fund të vitit 2009. Tregu i komunikimeve elektronike vazhdoi të rritet me ritme të larta në segmentet e telefonisë celulare dhe të Internetit, ndërsa për telefoninë fikse u vu re një reduktim i numrit të përdoruesve.

Në përmbushje të detyrimeve tona ligjore, AKEP ka vepruar me drejtësi dhe i pavarur, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese. Gjithashtu, kemi bashkevepruar me organet dhe strukturat përkatëse shtetërore në mbrojtje të interesave të përdoruesve dhe konsumatorëve për çështje që lidhen me zbatimin e ligjit 9918. Sic përcaktohet në ligj, ne punojmë për të zbatuar politikën e re të Qeverisë për sektorin.

AKEP vazhdon të monitorojë zhvillimet në nivel European, dhe do të kontribuojë për amendime të reja të legjisllacionit primar dhe sekondar që do të marrin në konsideratë vendimet e fundit (Dhjetor 2009) të Bashkimit European për kuadrin rregullator për sektorin e komunikimeve elektronike.

Detyra jonë është sigurimi i kushteve të favorshme tregu për investitorët, dhe ndihma në heqjen e barrierave të mbetura.

Interesat e qytetarëve dhe konsumatorëve janë në qendër të qëllimit të AKEP. Misioni ynë është të qenit një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikacioneve dhe postare duke kërkuar që të arrihet një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmim dhe cilësi më të mirë për të gjithë.

Nxitja e konkurrencës dhe mbrojtja e interesit të qytetarëve ka filluar të japë përfitime të prekshme - çmime më të ulta, më shumë zgjedhje, shërbime të reja dhe prezantim të teknologjive të fundit.

Sektorin e komunikimeve elektronike karakterizohet nga dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit. Ne përgatitemi për të përballuar sfidat e reja me të cilat do të ballafaqohemi në një të ardhme të afërt, kryesisht me konvergencën dixhitale të telekomunikacioneve dhe transmetimeve radio-televizive.

Më lejoni t'ju paraqes Raportin Vjetor, i cili përmban aktivitetet, ngjarjet dhe zhvillimet më të rëndësishme të ndodhura në sektor gjatë 2010, duke ju siguruar në angazhimin e AKEP për vazhdimësi në arritje.

Sinqerisht,

Piro XHIXHO

KRYETAR

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

AKEP është person juridik, publik, jobuxhetor, i cili drejtohet nga Këshilli Drejtues që është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë. Kryetari i Këshillit Drejtues është drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Kompetencat dhe detyrat e AKEP përcaktohen në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë dhe Ligjin nr. 10132, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”

MISIONI:

AKEP është një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikacioneve dhe postare duke kërkuar të arrijë një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmim dhe cilësi më të mirë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe postare në Shqipëri.

VLERAT THELBËSORE TË AKEP JANË:

Integritet

Paanësi

Transparencë

Profesionalizëm

Efikasitet

KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje jo më shumë se 1 herë. Kuvendi cakton kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues.



Piro XHIXHO

Kryetar

Lindur më 1952, diplomuar më 1975, “Inxhinier Elektronik” në Universitetin e Tiranës.

Që nga diplomimi punon në sektorin e postë-telekomunikacioneve me kulm të karrierës profesionale “Drejtor i Përgjithshëm i Postë-Telekomunikacioneve” në Ministrinë e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit.

Para marrjes së detyrës të Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP, më datë 26.11.2009, ka asistuar si ekspert projektsh të GTZ-së dhe Komisionit Evropian në Tiranë.



Alketa MUKAVELATI

Anëtar

Datëlindja 1975, diplomuar më 1998, “Jurist i Përgjithshëm” në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2000 fillon karrierën në sektorin e postë-telekomunikacioneve si juriste dhe para marrjes së detyrës së Anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP, më datë 26.11.2009, ushtronte funksionin “Drejtor i Përgjithshëm i Postë-Telekomunikacioneve” në Ministrinë e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit.



Benon PALOKA

Anëtar

Datëlindja 1971, diplomuar më 1993, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në “Matematikë-Fizikë”. Në vitin 2000 merr titullin “Master of Science in Information Systems Developmet” nga Universiteti i Hertfordshire. Punon si pedagog i informatikës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Para marrjes së detyrës së Anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP ishte në funksionin “Drejtor i Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit” në Kuvendin e Shqipërisë.



Ibsen ELEZI

Anëtar

Datëlindja 1973, diplomuar më 1998, “Inxhinier Programist” në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1998 fillon punën si programist, dhe para marrjes së detyrës së Anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP, më datë 26.11.2009, ushtronte funksionin “Drejtor i Arsimit Rajonal” Kukës.




Zamira NURÇE (XHIHOLLI)

Anëtar

Diplomuar më 1988, “Financier i Lartë” në Universitetin Bujqësor Tiranë. Në vitin 2007, merr titullin “Master në Politika Agrare”. Eksperiencën e fituar në sektorin e ekonomisë e demonstroi si pedagoge e jashtme pranë UAT përpara emërimit në detyrën e Anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP, më 26.11.2009.

ORGANIGRAMA E AKEP



1 PANORAMË E PËRGJITHSHME

Tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri ka njohur një zhvillim të shpejtë me liberalizimin e plotë të tij, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Numri i sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri në fund të vitit 2010 ishte 196 në krahasim me 152 në fund të vitit 2009. Referuar "Regjistrin të Sipërmarrësve" në lidhje me njoftimin për ofrim rrjetesh/shërbimesh gjendja në fund të vitit 2010, rezulton:

- ▶ Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës, i njëjtë me vitin 2009;
- ▶ Ofrim shërbimit publik telefonik fiks (të qëndrueshëm) – 82 sipërmarrës, kundrejt 73 në vitin 2009;
- ▶ Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 116 sipërmarrës, kundrejt 89 në vitin 2009;
- ▶ Ofrim shërbimi me vlerë të shtuar – 43 sipërmarrës, kundrejt 36 në vitin 2009;
- ▶ Ofrim të linjave me qera – 37 sipërmarrës, kundrejt 29 në vitin 2009.

Gjatë vitit 2010, tregu i komunikimeve elektronike vazhdoi të rritet me ritme të larta në segmentet e telefonisë celulare dhe të internetit, ndërsa për telefoninë fikse u vu re një reduktim i numrit të përdoruesve, i shoqëruar dhe me kalim të përdoruesve nga Albtelecom tek operatorët alternativë.

Financiare

Të ardhurat e sipërmarrësve deri në vitin 2009, kanë rezultuar në rritje të vazhdueshme. Në vitin 2010 të ardhurat ishin 57087 milion Lek që përbëjnë një reduktim prej 7.2% në krahasim me vitin 2009, kur të ardhurat ishin 61578 milion Lek. Ky reduktim i të ardhurave është në tendencë të kundërt me volumin e shërbimeve të cilët janë rritur ndjeshëm në vitin 2010 (Internet dhe telefoni celulare).

Katër operatorët celularë dhe Albtelecom, zotërojnë rreth 92% të të ardhurave të gjithë sektorit (reduktim nga niveli 95% në 2009), ndërsa operatorët e tjerë (Operatorët Alternativë) zotërojnë rreth 8% pjesë tregu (rritje nga niveli 5% në 2009). Të ardhurat e operatorëve celularë përbëjnë 73% të të ardhurave të të gjithë tregut, ndërsa operatori fiks Albtelecom zotëron 19%.

Ndër operatorët alternativë, tre sipërmarrësit me xhiro më të madhe janë ABCom, Primo dhe ASC, të cilët së bashku zënë rreth 4% të të ardhurave të sektorit (rritje nga niveli 2.5% në 2009) apo 50% të të ardhurave të të gjithë operatorëve alternativë.


Investimet

Për sa u përket investimeve të kryera në vitin 2010, tabela e mëposhtme paraqet të dhënat sipas deklarimeve të operatorëve.

Të punësuar

Numri i të punësuarve me kohë të plotë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike në vitin 2010 ishte 4240, prej të cilëve 40% ishin femra. Sipërmarrësi me numrin më të madh të të punësuarve është Albtelecom me 37% të të gjithë të punësuarve në sektor.

Figura 1. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2010)



Totali 2010 = 57087 Milion Lek

Figura 2. Tendanca e të ardhurave të sektorit dhe lojtarëve kryesorë në periudhën 2008-2010.




Tabela 1. Investimet e operatorëve në sektor për vitin 2011 (milion Lek)

	2010
Operatorët Fiks (Albtelecom dhe Operatorët Alternativë)	
Investime në infrastrukturë të rrjetit fiks (PSTN dhe IP)	732
Investime në infrastrukturë rrjet backbone FIBËR OPTIK	1070
Operatorët celularë	
Investime në infrastrukturë, rrjet celular	8089
Investime në infrastrukturë, rrjet backbone FIBËR OPTIK	1539

Figura 3. Struktura e të punësuarve në sektor (shpërndarja e të punësuarve) (2010)




Tabela 2. Numrin e të punësuarve në sektor në fund të vitit 2010.


	Operatorë Celularë	Albtelecom	Operatorë Alternativë	Total
Të punësuar me kohë të plotë	1,566	1,588	1,086	4,240
Të punësuar femra	844	602	274	1,720

1.1 Telefonia Celulare

1.1.1 Pjesët e tregut të operatorëve celularë

Në fund të vitit 2010, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 4.5 milion, i cili përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 140%¹. Norma vjetore e rritjes së numrit të përdoruesve ishte rreth 9% (rreth 360 mijë përdorues më shumë), që është shumë më e ulët se norma e rritjes vjetore prej 41% në vitin 2009 apo dhe me vitet e mëparshme. Rënia e normës së rritjes si dhe numri i lartë i përdoruesve për 100 banorë përbëjnë shenja se ky treg po i afrohet fazës së saturimit. Gjatë vitit 2010 rritje më të madhe ka pasur Eagle Mobile me 37% ndërsa AMC me 6%, ndërkohë që numri i përdoruesve të Vodafone Albania është rritur në masë shumë të vogël.

Figura 4. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë 2003-2010



Struktura e përdoruesve celularë, në përdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontratë), vazhdon të jetë e qëndrueshme dhe në vitin 2010, ku numri i përdoruesve me kontratë në raport me numrin total të përdoruesve celularë, është afërsisht 8%. Struktura e përdoruesve është e ngjashme të të katër operatorët celularë, megjithëse Eagle Mobile ka rreth 12% të përdoruesve me kontratë ndërsa më pak ka Plus Communication që ka rreth 5% të përdoruesve me kontratë.

¹ Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

Figura 5. Struktura e përdoruesve të operatorëve celularë




Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për vitin 2010, mbi numrin e pajtimtarëve celularë të detajuar në abonentë Familjarë dhe Biznes si dhe përdoruesit e shërbimeve të aksesit në Internet dhe pajtimtarët që kanë ndërruar program tarifor brenda të njëjtit operator.

Tabela 3. Pajtimtarët e operatorëve celularë për vitin 2010

	AMC	VF-AL	EAGLE	PLUS	Total
Numri i pajtimtarëve të telefonisë mobile në total i detajuar:	2,022,541	1,674,748	822,356	28,162	4,547,807
Përdorues familjarë	1,906,559	1,632,057	624,991	27,074	4,190,681
Përdorues biznes	115,982	42,691	197,365	1,088	357,126
Numri i pajtimtarëve që përdorin rrjetin celullr për akses në internet me GPRS/EDGE	710,000	143,542	276,979	27,433	1,157,954
Numri i pajtimtarëve që kanë ndërruar program tarifor brenda rrjetit	na	93,339	277,062	na	370,401

Figura 6. Të ardhurat (mil.Lek) dhe pjesët e tregut (%) të operatorëve celularë 2010






Figura 7. Të ardhurat totale të operatorëve celularë 2003-2010



	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
■ Vodafone	13,266	17,007	19,605	21,483	23,075	24,919	22,877	20,165
■ AMC	15,526	17,106	18,326	19,811	21,785	23,471	19,975	16,552
■ Eagle						600	4,362	5,166
■ Plus								10

Pjesët e tregut të operatorëve celularë kanë vazhduar të ndryshojnë, ku kryesisht ka pasur reduktim të pjesëve të tregut të AMC dhe Vodafone Albania dhe rritje të pjesëve të tregut të Eagle Mobile. Në fund të vitit 2010, Eagle Mobile ka arritur në 18% pjesë tregu për përdorues (27% për përdorues më kontratë), 12% në të ardhura dhe 9% për thirrje dalëse dhe SMS. Plus Communication si operator i ri ka arritur 1% pjesë tregut në numër përdoruesish në rreth 1 muaj aktivitet (fundi i muajit nëntor deri në fundin e vitit). Figurat e mëposhtme paraqesin pjesët e tregut për vitin 2010 për disa tregues kryesorë.

Figura 8. Pjesët e tregut të operatorëve celularë (2010)



1.1.2 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim jepet tabela me të dhëna për përdorimin mujor për përdorues celularë. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Përdorimi mujor i SMS i referohet vetëm mesazheve të dërguar. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme për përdorimin mesatar të një përdoruesi celular, i përlllogaritur me të dhënat e tre operatorëve celularë. Në vitin 2010, ka vazhduar tendenca e rritjes së ndjeshme të përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike që ka filluar në vitin 2009. Në vitin 2010, një përdorues celular ka kryer mesatarisht 80 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë 91 minuta thirrje hyrëse, duke rezultuar në 171 minuta komunikim në muaj (43% më shumë se në vitin 2009) dhe ka dërguar rreth 10 SMS në muaj (28% më pak se në 2009).

Tabela 4. Përdorimi mesator mujor i shërbimeve celulare

	2009	2010	Ndryshimi %
Thirrje dalëse në muaj	53	80	+52%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	67	91	+35%
MOU ²	120	171	+43%
SMS (dalëse) në muaj	14	10	-16%

Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve/përdoruesve celularë, reduktimi i të ardhurave totale dhe normave të fitimit të dy operatorëve celularë më të mëdhenj, rënia e çmimeve dhe të ardhurave mesatare për përdorues, rritja e ndjeshme e përdorimit mesatar të shërbimeve celulare gjatë viteve 2009 dhe 2010 në krahasim me vitet e mëparshme, janë tregues të qartë të rritjes së përfitimeve të abonentëve celularë nga konsumi i shërbimeve celulare.

1.2 Telefonia Fikse

1.2.1 Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut

Telefonia fikse në ndryshim nga telefonia celulare dhe Interneti, ka pësuar ndryshime shumë të vogla në numrin e pajtimtarëve, dhe vazhdon të ketë një penetrim shumë të ulët. Në fund të vitit 2010, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse arriti në rreth 331 mijë, nivel i cili përbën një reduktim në krahasim me 338 mijë që ishin në fund të vitit 2009. Ky reduktim erdhi si rezultat i reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me rreth 15 mijë abonentë apo 5% të numrit total, që përbën një tendencë të kundërt me rritjen e madhe në vitin 2009, (rritja më madhe në vitet e fundit). Ndërkohë në këtë periudhë ka një rritje të ndjeshme të numrit të pajtimtarëve nga operatorët alternativë me rreth 8 mijë pajtimtarë: nga 45 mijë në fund të vitit 2009 në 53 mijë në fund të vitit 2010. Kjo tregon se gjatë vitit 2010, ka pasur kalim të pajtimtarëve të Albtelecom tek operatorët alternativë që tregon se operatorët alternativë kanë arritur të konkurrojnë me Albtelecom në terma të çmimeve dhe cilësisë së shërbimeve. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2010, është 331 mijë, apo 10.2% penetrim, që përbën një normë shumë të ulët në krahasim me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit. Me gjithë rënien e numrit të pajtimtarëve në vitin 2010, Albtelecom zotëron rreth 84% të këtij tregu me rreth 278 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 16% me rreth 53 mijë pajtimtarë.

Albtelecom zotëron pjesë tregu mbi 80% të thirrjeve dhe në të ardhura për sektorin e telefonisë fikse. Thirrjet dalëse të përdoruesve të Albtelecom janë kryesisht thirrje lokale, 80% e tyre, ndërsa thirrjet ndërkombëtare zënë afërsisht 10%.


Operatorët alternativë kanë zgjeruar zonat e tyre të operimit dhe janë të përqendruar kryesisht në zonat më urbane dhe zonat rurale në afërsi të qyteteve. Struktura dhe niveli i tarifave të këtyre operatorëve është i ngjashëm me ato të Albtelecom. Një numër operatorësh alternativë ofrojnë njëkohësisht shërbime të telefonisë fikse, akses në Internet dhe TV. Ndër operatorët alternativë bie në sy ABCom që ka pasur një rritje të madhe në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010 të numrit të pajtimtarëve me paketa dyfishe dhe trefishe (internet, telefoni dhe TV), duke arritur mbi 13 mijë pajtimtarë dhe duke bërë që të jetë zotëruar i rreth 4% të tregut të telefonisë fikse dhe rreth 11% në akses Internet broadband.

1.2.2 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom

Në tabelën 5, paraqiten disa tregues konsumi mujor të thirrjeve të përdoruesve të Albtelecom. Përdorimi është matur sipas trafikut total dalës dhe hyrës (thirrje të marra përfshijnë edhe thirrjet brenda rrjetit Albtelecom, lokale

² Minutes Of Use: Minuta përdorimi të matura me shumën e thirrjeve dalëse dhe hyrëse.

Figura 9. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2009



dhe kombëtare), pjestuar me numrin mesatar vjetor të përdoruesve të Albtelecom. Rreshti i fundit parqet totalin e minutave të komunikimit (Minutes of Usage-MOU) nga një përdorues i Albtelecom, thirrje dalëse dhe të marra.

Nga tabela vihet re se konsumi i thirrjeve dalëse është në trend zbritës deri në fund të vitit 2009, por në vitin 2010 është vënë re një rritje në thirrjet dalëse totale si dhe në thirrjet e marra (hyrëse), e cila reflektohet edhe tek MOU, duke ndryshuar trendin që ishte në rënie deri në fund të 2009 dhe për vitin 2010 kemi një rritje të MOU.

Tabela 5. Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom 2003-2010

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Thirrje dalëse	296	187	227	239	180	164	136	151
Lokale dalëse	256	154	193	206	149	136	112	112
Mobile	14	12	13	12	12	11	10	7
Kombëtare drejt fiks	18	12	13	13	12	9	41	21
Ndërkombëtare	9	9	9	7	7	6	5	4
Thirrje të marra	314	207	242	255	205	191	181	204
MOU	610	394	469	493	386	355	317	356

Mesatarisht konsumi i thirrjeve të kryera është 144 minuta në muaj thirrje dalëse si dhe 204 minuta në muaj thirrje të marra, që do të thotë që një përdorues i Albtelecom gjatë vitit 2010 ka shpenzuar mesatarisht 356 minuta apo afërsisht 6 orë në komunikim në muaj me telefon fiks.

1.3 Interneti

1.3.1 Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet dhe struktura e tyre

Sipas të dhënave më të fundit nga operatorët dhe vlerësimeve të AKEP numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 110 mijë apo afërsisht 13.7% e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 10.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banorë është rreth 3.7%, krahasuar me 2.5% që ishte në fund të vitit 2009.

Ndarja e tregut për ofruesit e shërbimit të Internetit, ndërmjet Albtelecom dhe ofruesve të tjerë të këtij shërbimi, rezulton që Albtelecom zotëron rreth 59% pjesë tregu për numrin e pajtimtarëve. Ndër operatorët alternativë operatori ABCom rezulton me numrin më të madh me rreth 13 mijë apo 11% pjesë tregu për akses broadband.

Numri i pajtimtarëve (lidhjeve) broadband nëpërmjet ADSL të Albtelecom, deri në fund vitit 2010 është rreth 70 mijë pajtimtarë nga të cilët rreth 6% të tyre janë pajtimtarë biznes, kurse të tjerët janë pajtimtarë familjarë. Gjatë vitit 2010 numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet të Albtelecom, është rritur me rreth 20 mijë apo 35% krahasuar me fundin e vitit 2009.

Teknologjia kryesore vazhdon të jetë ADSL dhe operatori kryesor është Albtelecom, i cili ka qenë shume aktiv në shërbimet e aksesit në Internet, nëpërmjet investimeve në rrjetin lokal për të mundësuar ofrimin e shërbimit broadband nëpërmjet ADSL dhe reduktimit të tarifave për këtë shërbim. Nga të dhënat e raportuara vihet re se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri. Ndërkohë rreth 87% e abonentëve ADSL të Albtelecom përfitojnë akses në Internet me MSAN ku lidhja nga centrali telefonik deri në kabinet është me fibër optike dhe më pas me linjë bakri, e cila mund të konsiderohet si FTTN (Fiber To The Node).

Numri i abonentëve të Albtelecom që përdorin Internet me Dial Up ka rënie të ndjeshme duke arritur në rreth 1200, krahasuar me 14 000 në fund të vitit 2009. Kjo rënie mund të shpjegohet me rritjen e ndjeshme të alternativave për akses broadband në Internet.


Në këtë periudhë edhe operatorët celularë kanë qenë shumë aktivë në ofrimin e shërbimeve të Internetit nëpërmjet aparateve celulare dhe kartave modem për PC, duke ofruar reduktime të ndjeshme të tarifave të këtij shërbimi për përdorues me kontratë dhe me parapagim. Në fund të vitit 2010, numri i pajtimtarëve celularë (me kontratë dhe me parapagim) që kanë akses në Internet nëpërmjet aparatit celular me GPRS/EDGE është rreth 1.2 milion përdorues, ndërsa nuk ka ende të dhëna për aksesin broadband 3G. Vodafone Albania filloi menjëherë ofrimin e shërbimeve 3G në Tiranë dhe Durrës duke realizuar detyrimin brenda periudhës 2 mujore të marrjes së autorizimit.

Gjatë vitit 2010, janë vënë re dhe disa ndryshime cilësore në ofrimin e aksesit broadband në Internet:

- **Rritje e shpejtësisë së aksesit në Internet broadband ADSL** nga intervali 256kbps-2mbps në 2mbps-12mbps, ku shpejtësia minimale dhe më e përdorur është 2mbps krahasuar me 256 kbps në 2009.
- **Konektiviteti me Internetin Global (lidhjet direkte ndërkombëtare)** është rritur nga rreth 6 Gbps në fund të vitit 2009, në rreth 14 Gbps në fund të vitit 2010.
- Ofrimi i paketave të kombinuara: Internet, TV dhe Telefoni nga OA

Gjatë vitit 2010 është vënë re reduktim i ndjeshëm i tarifave për aksesin broadband. Nga krahasimi rezulton se tarifat aktuale të aksesit broadband në Internet, për shpejtësinë 2 Mbps pa limit, në Shqipëri janë në nivelin mesatar ose në nivel më të ulët se vendet e rajonit (për inkumbent dhe operatorët alternativë).

Figura 10. Krahasimi i tarifave të aksesit broadband 2 Mbps pa limit me vendet e rajonit



Ky përbën një përmirësim të ndjeshëm me vitet e mëparshme kur tarifa për akses 2 Mbps ishte në nivelin më të lartë në rajon. Tarifat për aksesin broadband me kapacitete të kufizuar download janë më të ulëta, p.sh. tarifa më e ulët për 2mbps nga Albtelcom është 999 Lek/muaj, paketë e cila aktualisht përdoret nga shumica e abonentëve broadband të Albtelcom.

Sipas të dhënave të ISP-ve, për vitin 2010, numri i pikave Wi-Fi Hot Spots vlerësohet të jetë rreth 1400, ndërsa numri i Internet kafeve rreth 1000.

2 VEPRIMTARIA E RREGULLIMIT EKONOMIK TË TREGUT

Gjatë vitit 2010, veprimtaria e AKEP për rregullimin ekonomik të tregut të komunikimeve elektronike ishte e përqendruar në aspektet e mëposhtme:

- Procesi i analizave të tregjeve dhe përcaktimit të Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT);
 - telefonisë së lëvizshme
 - telefonisë fikse
 - linjave me qira
 - aksesin në internet broadband (LLU)
- Rregullimi i Interkoneksionit.
- Zhvillimi dhe përfundimi i projekteve për përlllogaritjen e kostove BULRAIC celulare dhe të Albtelcom

2.1 Analizat e Tregjeve

Në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, AKEP gjatë vitit 2010, nxori për konsultim publik analizën e tregut të aksesit broadband dhe miratoi versionet finale dhe vendimet për FNT në tregjet celulare dhe të telefonisë fikse.

2.1.1 Procesi i analizave të tregjeve gjatë vitit 2010

a) Më datë 31.03.2010, u publikua versioni final i analizës së tregut të telefonisë së lëvizshme, e cila përmban analizën e tregjeve nr.8, nr.16 dhe nr.17, të Rregullores “Për Analizën e Tregut” (apo tregjet nr. 15 dhe 16 të Rekomandimit të KE (2003/311/EC) si dhe tregun me pakicë celulare):

- Tregu me pakicë të aksesit dhe shërbimeve nëpërmjet rrjeteve mobile.
- Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme;
- Tregu me shumicë të aksesit dhe origjinimin e thirrjeve në rrjetet telefonike publike të lëvizshme

AKEP me vendimet nr.1210, 1211 dhe 1212, datë 31.03.2010, përcaktoi sipërmarrësit me FNT:

- AMC sh.a në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin AMC dhe në tregun me shumicë të akses/origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare;
- Vodafone Albania në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania dhe në tregun me shumicë të akses/origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare;
- Eagle Mobile në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile.

Nëpërmjet këtyre vendimeve u përcaktuan dhe masat rregulluese (detyrimet) për sipërmarrësit me FNT në tregjet përkatës, të tilla si detyrimet e transparencës, mos-diskriminimit, dhënie akses dhe orientimit në kosto të tarifave. Detyrimet për terminimin e thirrjeve për të tre operatorët janë të njëjta dhe përfshijnë të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin 9918, ndërsa për origjinimin e thirrjeve për AMC dhe Vodafone Albania, detyrimet për kontrollin e tarifës u vendosën për thirrjet drejt numrave 0800 dhe numrave të aksesit për platformat e kartave me parapagim.

b) Më datë 26.07.2010, AKEP publikoi analizën finale të tregut të telefonisë fikse, që përmban analizën e tregjeve nr.1-6 dhe 9-11 të Rregullores “Për Analizën e Tregut”:

- Tregu me pakicë i aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse për klientët familjarë;
- Tregu me pakicë i aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse për klientët jo-familjarë;
- Tregu me pakicë për shërbimet lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun të ofruar nga vendndodhje fikse për klientët familjarë.
- Tregu me pakicë për shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientët familjarë.
- Tregu me pakicë për shërbimet lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun të ofruar nga vendndodhje fikse për klientët jo-familjarë.
- Tregu me pakicë për shërbimet ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientët jo-familjarë.
- Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruar nga vendndodhje fikse.

- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse.
- Tregu me shumicë i shërbimeve transite në rrjetet telefonike publike fikse.

Bazuar në këtë analizë tregu me vendimin nr.1348, datë 26.07.2010, AKEP përcaktoi Albtelecom me FNT në tregjet përkatës të mësipërm duke vendosur detyrimet për transparencën, mos-diskriminimin, kontrollin e tarifave dhe orientimin në kosto, dhe dhënien akses për zgjedhje/parazgjedhje të bartësit. AKEP përcaktoi që zbatimi i detyrimeve të orientimit në kosto të tarifave të interkoneksionit, përfshirë ribalancimin e plotë të tarifave të pajtimtarëve të Albtelecom dhe detyrimet për zgjedhjen/parazgjedhjen e bartësit, do të kryhet në bazë të përcaktimeve të ardhshme të AKEP, nëpërmjet një vendimi që do të merret bazuar në rezultatet e modelit BULRAIC të përfunduar në muajin Korrik 2010. Për këtë do të kryhet një konsultim publik me të gjitha palët e interesuara, proces që konsiderohet shumë i rëndësishëm nga AKEP për shkak edhe të efekteve sociale që mund të ketë ndryshimi i tarifave me pakicë për orientimin në kosto të tyre.

c) Më datë 13.04.2010 u publikua për konsultim publik analiza e tregjeve me shumicë të shërbimeve të aksesit në rrjete fikse dhe broadband, që përmbajnë analizat e tregjeve nr.14 dhe 15, të Rregullores “Për Analizën e Tregut”:

- Tregu me shumicë i linjave kryesore (trunk) të linjave me qera.
- Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e ndarë të pjesëshëm ose të plotë) nga vendodhje fikse.
- Tregun me shumicë të aksesit broadband .

d) Më 17.01.2010 përfundoi periudha e konsultimit publik të nisur me datë 17.11.2009, datë në të cilën u publikua për konsultim publik analiza e tregjeve me pakicë dhe me shumicë të linjave me qera, apo tregjet nr.7, 12 dhe 13 të Rregullores “Për Analizën e Tregut”, apo tregjet nr.7, 13 dhe 14 të Rekomandimit të KE (2003/311/EC) dhe konkretisht:

- Tregu me pakicë i minimumit të linjave me qera (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qera deri në 2Mb/sek)
- Tregu me shumicë i segmenteve terminuese të linjave me qera;
- Tregu me shumicë i linjave kryesore (trunk) të linjave me qera;

2.2 Rregullimi i Interkoneksioni

2.2.1 Tarifat

Tarifat e interkoneksionit të tre operatorëve me FNT, AMC, Vodafone dhe Albtelecom, për periudhën Shtator 2008-Shtator 2010, ishin nën rregullim nëpërmjet metodologjive të rregullimit të tarifave të miratuara nga Këshilli i Ministrave me Vendimet Nr.853, Nr.854, dhe Nr.855 datë 18.06.2008. Nëpërmjet këtyre metodologjive ishte përcaktuar niveli maksimal për çdo periudhë 6-mujore për Albtelecom dhe çdo periudhë 1-vjeçare për AMC dhe Vodafone Albania, për një kohëzgjatje prej 2 vjetësh. Gjatë vitit 2010 vazhdoi implementimi i tarifave përkatëse sipas përcaktimeve të metodologjive për secilin operator.

Në vijim të vendimeve për FNT më 31.03.2010 për telefoninë celulare, me shpalljen e Eagle Mobile si operator me FNT për terminimin, dhe për Vodafone Albania dhe AMC edhe për origjinimin e thirrjeve, AKEP përcaktoi nivelin e tarifës së origjinimit në rrjetet Vodafone Albania dhe AMC në nivelin 10.5 Lek/minutë të njëjtë me nivelin e tarifës së terminimit. Tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile, pas procesit të ankimit administrativ të këtij të fundit, u përcaktua në nivelin 12.92 Lek/minutë, apo 23% më e lartë krahasuar me 10.5 Lek/minutë për AMC dhe Vodafone Albania. Gjithashtu, në vijim të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis Plus Communication

dhe 3 operatorëve celularë dhe Albtelcom, AKEP vendosi që tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication të ketë 80% asimetri në krahasim me tarifën e AMC/Vodafone Albania. Vendosja e këtij niveli asimetrie u gjykua i arsyeshëm nga AKEP për shkak të kohës së hyrjes në treg të Plus Communication (viti 2010) në krahasim me dy operatorët e tjerë (në vitet 1996, 2001) si dhe fazës në të cilën ndodhet tregu celular (mbi 130% penetrim në atë periudhë).

2.2.2 Rregullore dhe RIO-t

Në lidhje me aksesin dhe interkoneksionin në muajin Qershor 2010, AKEP miratoi rregulloret e mëposhtme:

- Rregullore nr.19, datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” (e cila zëvendësoi rregulloren e mëparshme miratuar në Dhjetor 2007).
- Rregullore nr. 18, datë 11.06.2010 “Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”

Në vijim të vendimeve për FNT dhe detyrimeve të publikimit të ofertave referencë, AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Albtelcom dorëzuan në muajin Tetor 2010, ofertat referencë të interkoneksionit (RIO-t) përkatëse. AKEP para marrjes së vendimeve për miratimin e RIO-ve, kërkoi komentet e palëve të interesuara për RIO-t e dorëzuara nga operatorët me ndryshimet e propozuara nga AKEP. Më datë 23.12.2010, AKEP miratoi ofertat referencë të AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile, duke imponuar ndryshime në secilën ofertë të propozuar nga operatorët. Ndryshimet e imponuara nga AKEP synonin në heqjen e barrierës së afatit njëvjeçar të marrëveshjeve të interkoneksionit të cilat rezultojnë në kosto të larta administrative dhe shkak për moslidhje marrëveshje interkoneksioni, si dhe përfshirjen e marrëveshjeve të nivelit të shërbimeve në RIO me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përgjegjshmërisë së palëve për interkoneksionin.

2.3 Përcaktimi i kostos së ofrimit të shërbimeve nga operatorët me FNT

Në vijim të kontratave të nënshkruara në vitin 2009, me dy kompani konsulencë ndërkombëtare për përlllogaritjen e kostove të shërbimeve të telefonisë fikse dhe celulare nëpërmjet metodës Kosto Shtesë (Inkrementale) Mesatare Afat Gjatë (Long Run Average Incremental Cost) që përdoret si standardi kryesor për llogaritjen e çmimeve për shërbimet me shumicë të telekomunikacioneve, e cila rekomandohet nga Komisioni Evropian³, AKEP gjatë vitit 2010 u përqendrua në zhvillimin e modeleve pra, përfundimin me sukses të të dy projekteve.

Të dy projekte përfunduan në Korrik 2010, dhe kompanitë konsultuese dorëzuan modelet finale dhe rezultatet përfundimtare të tyre.

Në vijim të mbylljes së projektit të kostove BULRAIC për telefoninë celulare, AKEP pas konsultimit publik të dokumentit: “Orientimi në Kosto të Tarifave të Shërbimeve Celulare të Operatorëve me FNT” mori vendimet përkatëse për orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve me shumicë të operatorëve celularë me FNT.

AKEP, bazuar në rezultatet e modelit BULARIC për Albtelcom, është duke përgatitur një dokument për orientimin në kosto të tarifave me shumicë dhe me pakicë të Albtelcom. Ky dokument do t'i nënshtrohet konsultimit publik dhe AKEP do të marrë më pas vendime për orientimin në kostot BULRAIC të tarifave me shumicë të Albtelcom dhe ribalancimin e plotë të tarifave me pakicë. Ky proces është shumë i rëndësishëm për ecurinë e tregut të telefonisë fikse dhe stimujve për të investuar në këtë sektor, sidomos për linjat telefonike fikse ku Shqipëria ka një nivel penetrimi shumë të ulët dhe që përbën pengesë edhe për zhvillimin e Internetit broadband, për implementimin efektiv të masave për LLU, të cilat do të kenë si rezultat final rritjen e përfitimeve të konsumatorëve nga telefonia fikse dhe interneti broadband.

³ Rekomandimet e KE të vitit 1998 dhe 2002, si dhe një sërë rekomandimesh të ERG, dhe rekomandimi më i fundit i KE: COMMISSION RECOMMENDATION of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC), që rekomandon metodën BULRAIC.

3 VEPRIMTARIA E RREGULLIMIT TEKNIK

Rregullimi teknik i tregut të telekomunikacioneve është një nga aspektet kryesore të veprimtarisë së AKEP, që së bashku me rregullimin ekonomik përbëjnë bazat mbi të cilat kryhet rregullimi në tërësi i tregut të telekomunikacioneve. Rregullimi teknik realizohet për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe të standardizuara teknike që çojnë në një konkurrencë të ndershme dhe përdorimin me efektivitet të burimeve të fundme në dispozicion siç janë frekuencat dhe seritë numerike.

Gjatë vitit 2010, puna për rregullimin teknik të tregut ka konsistuar kryesisht në:

- ▶ Administrimin me efektivitet të spektrit të frekuencave;
- ▶ Miratimin e standardeve dhe treguesve të cilësisë së shërbimit;
- ▶ Administrimin dhe liberalizimin e vazhdueshëm të domain-ëve nën .al

AKEP, gjatë vitit 2010, u angazhua maksimalisht në përmbushjen e një detyrimi ligjor të porealizuar: “Implementimin e Portabilitetit të Numrit”. Ndryshimi i numrit telefonik përbën një shqetësim dhe është një barrierë potenciale në pengimin e përdoruesve për të përfituar nga avantazhet e ofertave të mundshme në një treg telekomunikacionesh me konkurrencë të zhvilluar.

Puna për realizimin e portabilitetit të numrit filloi më datë 07.01.2010, me ngritjen e grupit të punës për administrimin e procesit të “Portabilitetit të Numrit” dhe më 22 Dhjetor 2010, u firmos kontrata me firmën fituese për “Ngritjen e Bazës së të Dhënave Referencë të Centralizuar për Ofrimin e Portabilitetit të Numrit” e cila mundësoi ofrimin e bartjes së numrit brenda muajit Maj 2011.

3.1 Administrimi i spektrit të frekuencave

Puna për administrimin me eficientë të spektrit të frekuencave ka konsistuar në:

- ▶ Studimin e disa brezave të frekuencave: Lidhje Fikse, BWA (Broadband Wireless Access) dhe FWA (Fix wireless Access), Dividenti Numerik, GSM/UMTS dhe PMR (Private Mobile Radio). Qëllimi i këtij studimi ishte rritja e efektshmërisë së përdorimit të spektrit të frekuencave; dhënia e një tabloje të qartë të aspektit rregullues për kushtet teknike që duhet të përmbushen në çdo përdorim brezi (niveli i lejuar i interferencës, fuqia, përhapja, etj); nxitja e përdorimit të teknologjisë dixhitale në brezat e caktuar, etj.
- ▶ Hartimin, përditësimin dhe publikimin e Planit të Përdorimit të Frekuencave. Miratimi i këtij plani është bërë për herë të parë nga AKEP dhe publikimi i tij ka filluar nga muaji mars 2010. Në funksion të këtij plani po punohet për të bërë të mundur aplikimet on-line për frekuenca dhe numra si dhe bërjen efektive të bazës së të dhënave SMS4DC. Janë hedhur të dhënat teknike në sistemin SMS4DC të stacioneve, është implementuar harta dixhitale DEM (Digital Elevation Model) me rezolucion 30m/pixel, janë ndarë kanalet në SMS4DC sipas Rekomandimeve dhe Vendimeve CEPT.
- ▶ Përditësimin e Planit Kombëtar të Frekuencave. AKEP ka miratuar propozimin për Ministrin për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e Komunikimit mbi përditësimin e PKF-së.
- ▶ Dhënien e autorizimit për përdorimin e brezave të frekuencave për ofrimin e shërbimeve të mbështetur në teknologjinë UMTS. Këshilli Drejtues i AKEP, më datë 02.12. 2010, miratoi pajisjen e sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a me autorizim individual, për përdorimin e frekuencave në brezat (1920-1935) MHz çiftuar me (2110-2125) MHz dhe (1900-1905) MHz, spektër i paçiftuar, për ndërtimin e rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve të lëvizshme tokësore me brez të gjerë. Ky autorizim individual u lëshua në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, ku sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a u shpall fitues me çmim të ofertës në vlerën 31.400.000 (tridhjetënjë milionë katërqindë mijë) Euro.

3.2 Miratimi i standardeve dhe treguesve të cilësisë së shërbimit

Rregullimi teknik realizohet për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe të standardizuara teknike që çojnë në një konkurrencë të ndershme. Në qëllim të këtij aspekti gjatë vitit 2010, u punua për:

- Rregullore “Për kushtet e përdorimit të frekuencave dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren pa autorizim individual”- miratuar me VKD nr.1126, datë 08.01.2010.
- Rregullore “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”-miratuar me VKD nr.1256, datë 16.04.2010. Rregullorja përcakton kriteret e matjes, mbajtjes, publikimit dhe raportimit të treguesve të cilësisë së shërbimit.
- Rregullore “Për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtare (NSPC) dhe ndërkombëtare (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”-miratuar me VKD nr.1257, datë 16.04.2010. Deri në 2010 nuk kishte asnjë rregull dhe asnjë institucion që administronte kodet NSPC/ISPC. Me iniciativën e AKEP u kontaktua sipërmarrësi me numrin më të madh të kodeve në administrim i cili për hir të trashëgimisë së tregut monopol kishte edhe regjistrin e kodeve-Albtelecom. Pas akordit me Albtelecom u përgatitën të gjitha procedurat e transferimit dhe rregullat e administrimit nga AKEP. Për këtë u shfrytëzuan eksperiencat më të mira në Evropë. Aktualisht kodet NSPC/ISPC administrohen nga AKEP.
- Amendimi i rregullores “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve”-miratuar ndryshimet me VKD nr.1396, datë 28.08.2010
- Hartimi i dokumentit rregullator “Kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablore urbane dhe infrastrukturës së rrjeteve me fibra optik ndërrbane të komunikimeve elektronike.

3.3 Administrimi dhe liberalizimi i vazhdueshëm i domain-eve nën .al

Bazuar në nenin 8, germa (k) të ligjit 9918, administrimi i emrave të domain-eve në zonën .al dhe nën domain-et .com.al, .org.al, .gov.al, .edu.al, .mil.al dhe .net.al është kompetencë e AKEP. Ky administrim bëhet në bazë të rregullores përkatëse e cila gjatë vitit 2010, ka pësuar dy ndryshime të rëndësishme;

- Në dhënien e të drejtës për regjistrim domain përveç personave juridikë publikë dhe privatë, personave fizikë tregtar edhe personave natyrorë.
- Çmimi nga 75\$ në dy vjet, u reduktua në 2000 lek në dy vjet, duke qenë poshtë mesatares Evropiane që është 18\$ në vit.

Aktualisht, aplikimi dhe konfirmimi i një domain bëhet on-line, ndërsa procesimi në mënyrë manuale. Në vitin në vazhdim është parashikuar liberalizimi i plotë i regjistrimit dhe administrimit të domain.al, duke kaluar në sistemin “Regystry-Registrar”, ku u jepet e drejta e regjistrimit subjekteve të ndryshme ndërsa në AKEP mbahet regjistri i domain-eve.

Në tabelën e mëposhtme jepet efekti i hapave liberalizues të regjistrimit të domain.al për vitin 2010.

Tabela 6. Numri i domain-eve të regjistruar

Domain	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2009	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2010
.al	1182	3912
.com.al	309	435
.gov.al	160	192
.org.al	93	93
.edu.al	75	81
.net.al	12	18
.mil.al	8	8

4 VEPRIMTARIA JURIDIKE NË RREGULLIM

Veprimtaria juridike e AKEP gjatë vitit 2010, kryesisht ka konsistuar në:

- Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të telekomunikacionit.
- Pjesëmarrjen si palë e paditur apo palë e tretë në procese gjyqësore.

4.1 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të telekomunikacionit

Miratimi i ligjit 9918, në konformitet me paketën rregullatore të BE-së 2002/2003, ka si qëllim liberalizimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, heqjen e barrierave për hyrjen në treg, të cilat çojnë në rritje të konkurrencës. Me zbatimin e këtij ligji, siç është përmendur dhe më sipër, në “Regjistrin e Sipërmarrësve” numri i sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë në fund të viti 2010 ishte 196. Rritja e numrit të sipërmarrësve ka sjellë dhe rritjen e numrit të mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre. Në bazë të nenit 8, gërma (n) të ligjit 9918, AKEP ka ushtruar kompetencat e tij në zgjidhjen e 10 mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve nëpërmjet ezaurimit të të gjitha staveve të një procedimi administrativ.

4.2 Pjesëmarrja në procese gjyqësore

Gjatë vitit 2010, AKEP ka marrë pjesë në 21 procese gjyqësore ndër të cilat në 18 çështje është thirrur si palë e paditur dhe në 3 çështje si palë e tretë.

Për proceset gjyqësore në cilësinë e palës së paditur AKEP:

- Ka fituar 7 çështje;
- Ka humbur 3 çështje;
- Janë ne proces 4 çështje;
- Janë nxjerrë jashtë juridiksionit 3 çështje ;
- Është pushuar 1 çështje;

5 VEPRIMTARIA INSPEKTUESE DHE MONITORUESE

5.1 Veprimtaria inspektuese

Ushtrimi i veprimtarisë inspektuese në vitin 2010, u realizua bazuar në:

- inspektime me karakter të përgjithshëm; dhe
- inspektime me tematikë specifike.

Përsa i përket inspektimeve me karakter të përgjithshëm, në bazë të programeve tre-mujore të zbërthyer në programe mujore u inspektua veprimtaria e 45 sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm të regjistruar në “Regjistrin e Sipërmarrësve”.

Gjithashtu gjatë vitit 2010 u kryen edhe 5 inspektime me tematikë specifike si më poshtë:

- ▶ Në muajin korrik u realizua inspektimi i sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Plus Communications” sh.a. mbi verifikimin e të dhënave të dërguara nga ky sipërmarrës për hyrjen në treg dhe fillimin e ofrimit të shërbimit. Gjithashtu u bë verifikimi i shtrirjes dhe konfigurimit të rrjetit përpara fillimit të ofrimit të shërbimit të telefonisë së lëvizshme.
- ▶ Në muajin shtator, u fillua procedura e inspektimit pranë ambienteve të **36 ofruesve** të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike me objekt zbatimin nga ana e sipërmarrësit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, të detyrimit ligjor për depozitimin e të dhënave dhe informacionit të kërkuar nga AKEP në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9918, dhe rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
- ▶ Në tremujorin e tretë u inspektuan sipërmarrësit e komunikimeve elektronike “AMC” Sh.a, “Vodafone Albania” Sh.a, “Eagle Mobile” Sh.a mbi zbatimin e vendimeve të AKEP në lidhje me kontratat e miratuara të pajtimtarëve të telefonisë celulare. Nga këto inspektime rezultoi se këta sipërmarrës i kishin zbatuar kontratat konform kontratës së miratuar me VKD-të të AKEP.
- ▶ Së fundi, në mbështetje të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme u ngritën dy grupe inspektimi (taskforce), për inspektimin e sipërmarrësve debitorë. Kryerja e këtyre inspektimeve konkludoi në arkëtimin e shumës prej 34,712,306 Lek të sipërmarrësve debitorë.

Veprimtaria inspektuese gjatë vitit 2010, ka qenë në nivel shumë më të lartë se viti 2009, jo vetëm nga numri i inspektimeve të kryera përkatësisht 84, kundrejt 20, por nga evidentimi i përmirësimeve që duhet të ndodhin në kuadrin ligjor dhe atë nënligjor.

Për sa më sipër, në fund të vitit 2010 u hartua projekt-rregullore e re “Për inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike”.

5.2 Veprimtaria monitoruese

Njësia monitoruese e spektrit të frekuencave, gjatë vitit 2010, ka ushtruar veprimtarinë bazuar në “Rregullore e Brendshme e Sektorit të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave” miratuar në Shkurt 2010. Veprimtaria monitoruese ka konsistuar në:

- ▶ monitorimin e brezit GSM (900 dhe 1800 MHz) përgjatë rrugëve kombëtare, për verifikimin e nivelit të mbulimit me sinjal nga kompanitë celulare AMC sh.a, Vodafone Albania sh.a., dhe Eagle Mobile sh.a. Ky monitorim u krye bazuar në problemet e ngritura nga disa deputetë të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin për mosmbulim me sinjal nga operatorët celularë të disa segmenteve të akteve rrugore, në mbledhjen e të datës 15.03.2010, ku u paraqit raporti i veprimtarisë të vitit 2009 të AKEP. Nga rezultatet e matjeve u hartua një raport dhe u krijua një hartë e mbulimit me sinjal GSM. Kopje të kësaj harte iu dërguan kompanive që ofrojnë shërbimin e telefonisë së lëvizshme, dhe Komisionit;
- ▶ kontrollin dhe monitorimin e brezave UHF dhe VHF për të verifikuar subjektet e rinj të pajisur me autorizim individual për përdorim të frekuencave si dhe ata që kanë deklaruar ndërprerjen e aktivitetit, duke mundur në këtë mënyrë edhe përditësimin e bazës të të dhënave të disponuar nga AKEP.
- ▶ verifikimi i ankesave të subjekteve për interferencë;
- ▶ skanimi i brezit 3.4-3.8 GHz në disa qytete të vendit.

6 RREGULLIMI I TREGUT POSTAR

Në bazë të ligjit 9918, dhe ligjit nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin nr. 10132, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, funksionet rregullatore për sektorin postar kanë kaluar nga Ministri në AKEP. Në mungesë të një strukture permanente që merret me rregullimin postar, ndjekja e problemeve të këtij sektori është realizuar në bazë të urdhërave të nxjerra nga Kryetari për ngritje grupe pune për aspekte të veçanta të tregut.

Në fillim-vitin 2010, u organizua një takim në ambientet e AKEP me të gjithë ofruesit e shërbimeve postare, ku ju bënë të njohura dhe u dhanë sqarimet përkatëse në lidhje me ndryshimet ligjore.

Në periudhën mars-prill 2010, një grup adhoc i AKEP ushtroi kontroll në 4 ofrues shërbimesh postare me tematike “respektimin e zonës së rezervuar të operatorit publik postar “Posta Shqiptare”. Kontrolli u ushtrua për verifikimin e ankesave të “Posta Shqiptare” për çënimin e zonës së rezervuar.

Pavarësisht mungesës së strukturës me persona të specializuar për shërbimet postare, së fundmi u hartua projekt-rregullore “Për dhënie e Liçencës së Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare”.

Projekt-struktura e AKEP e përcjellë në Kuvend për miratim, parashikon ngritjen e sektorit të shërbimeve postare.


7 STRUKTURA DHE BURIMET NJERËZORE

Në zbatim të Ligjit Nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuar me ligj” i ndryshuar, dhe Vendimit të Kuvendit nr. 97, datë 30.04.2007, ndryshuar me Vendimin nr.178, datë 14.04.2008, është miratuar struktura organizative dhe organika e ERT-së (AKEP) për vitin 2007 e 2008, me numër të përgjithshëm të punonjësve në 60 vetë, mbi bazën e të cilës AKEP ka ushtruar funksionet edhe për vitin 2010.

8 REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË VJETORË TË AKEP

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.104, datë 17.02.2010, fondi i shpenzimeve të AKEP, u miratua në shumën 230,500,000 Lekë dhe u realizua 264,836,541 Lekë. Performanca e treguesve ekonomiko-financiarë të AKEP-it paraqitet në grafikët më poshtë:

Figura 11. Struktura e punonjësve në AKEP



Deri më tani, 91.6% e të ardhurave vijnë nga pagesat për frekuenca që bëhen pranë AKEP dhe 8.4% nga pagesat për numeracion, miratim tipi, regjistrim domain, etj.

Figura 12. Treguesit financiarë të AKEP për vitin 2010




Figura 13. Realizimi i Shpenzimeve

